



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 31 korrik 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3350_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 30, Nenit 32 paragrafin 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 34 dhe Nenit 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Nr.07/2017); "Marrëveshjen për Blerje të Energjisë (MBE) për Kapacitetet Gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, sipas kornizës së rregulluar, të lidhur me datë 04.10.2024 nr.2882 në mes ndërmarrjes EV Wind Park SH.P.K. – ZATRIC -1 dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A; si dhe Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 26.06.2026 nga ndërmarrja EV Wind Park SH.P.K., adresa Rr. "Agim Ramadani", Nr. 125, kat 2/4, 10000-Prishtine (Lokacioni ZK Zatric Rahovec), Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 31 korrik 2026, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET LICENCA për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Parku Energjetik me Erë "ZATRIQ 1", ndërmarrjes EV Wind Park SH.P.K., me numër licence ZRRE/Li_120/26, për periudhën dyzet (40) vjeçare, nga data 31.07.2026 deri me datë 30.07.2066.**
- II. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **EV Wind Park SH.P.K.**, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 26.06.2026 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja EV Wind Park SH.P.K., nga gjeneratori Parku i Erës ZATRIQ -1 , me kapacitet të instaluar prej 35 MW.
- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **EV Wind Park SH.P.K.**, me datë 23.07.2026 ka njoftuar palët e interesit përmes gazetave online, se ka dorëzuar aplikacionin në Rregullator për licencim të aktivitetit të **prodhimit** të energjisë elektrike për shqyrtim sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të parashtrajnë kundërshtime në aplikacion, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur



njoftimi është publikuar. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim nga palët e interesit, për këtë aplikacion.

- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- Bordi i Rregullatorit ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kështu duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 25 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Ganj Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

**Bashkëngjitur licenca për Prodhim.*

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes EV Wind Park SH.P.K,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.